



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë - Ministarstvo Industrije,
Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade*

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr. 06/2024 PËR PËRCAKTIMIN E
RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR ADMINISTRIMIN E KUOTAVE NË
IMPORT**

Ministrja e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Në mbështetje të nenit 10, paragrafi 9, të Ligjit Nr. 08/l-021 për Tregti me Jashtë, nenit 11 paragrafi 1 nëparagrafi 1.3. të Ligjit Nr.08/L-117 Për Qeverinë e Republikës së Kosovës, si dhe nenit 9, paragrafi 2 të Rregullores Nr. 17/2024 e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës,

Nxjerrë:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MINT) Nr.06/2024 PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR ADMINISTRIMIN E KUOTAVE NË IMPORT

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Udhëzim Administrativ përcaktohen rregullat dhe procedurat për administrimin e kuotave në import, kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së kuotave për importimin e produkteve brenda kuotës.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen nga Ministria përkatëse për tregti, ministritë në fushëveprimin e të cilit janë produktet për të cilat përcaktohet kuota si dhe operatorët ekonomik që merren me veprimtari tregtare.

Neni 3 Përkufizime

1. Termat e përdorura në këtë udhëzim kanë këtë kuptim:

1.1. Kuotë tarifore - regjim tarifor prej dy nivelesh i cili përcakton një prag sasior për një periudhë të caktuar kohore për importet e një produkti specifik; importet brenda kuotës hyjnë me një tarifë më të ulët (brenda kuotës) ndërsa për importet mbi nivelin e pragut vendoset tarifë më e lartë (jashtë kuotës);

1.2. "Administrimi i Kuotave Tarifore" - është një masë që siguron zbatimin korrekt të dispozitave për kuotat tarifore;

1.3. "Ministria" - ministria përgjegjëse për tregtinë;

1.4. "Ministria e fushës përkatëse" - Ministrinë në fushëveprimin e të cilit janë produktet për të cilat përcaktohet kuota;

1.5. Afati kohor - periudhën kohore e përcaktuar për zbatimin e një kuote tarifore;

1.6 Leja e importit automatike - është një autorizim që lëshohet pa kufizime ose kontrole të mëtejshme. Çdo kërkesë e kompletuar për një licencë miratohet automatikisht pa vonesa dhe pa kushte të veçanta.

1.7 Leja e importit jo automatike - është një autorizim që mund të jetë subjekt i kufizimeve dhe kontroleve specifike. Kjo lloj leje përdoret për të menaxhuar kuotat dhe për të mbrojtur interesa specifike, siç janë mbrojtja e industrisë vendase, shëndeti publik dhe siguria kombëtare.

1.8 Ligji – Ligji për Tregti me Jashtë.

Neni 4

Mënyra e vendosjes së kuotave tarifore

1. Në rastin e kufizimeve të importit që përfshijnë vendosjen e kuotave tarifore, kuotat tarifore vendosen përmes marrëveshjeve tregtare bilaterale dhe në mënyrë të njëanshme.

2. Kur Kuotat tarifore vendosen përmes marrëveshjeve bilaterale, vlera ose sasia e mallrave të caktuara që mund të importohen në vend gjatë një periudhe të caktuar kohore caktohet përmes marrëveshjes me vendin përkatës.

3. Kur kuotat tarifore vendosen në mënyrë të njëanshme, vlera ose sasia e mallrave, importi i të cilave kufizohet përmes kuotave në import, përcaktohet me vendim nga Qeveria e Republikës së Kosovës në bazë të propozimit të Ministrisë, siç përcaktohet edhe në Nenin 9 paragrafi 3 i Ligjit.

4. Propozimi i Ministrisë bazohet në kërkesat e Ministrisë së fushës përkatëse për vendosjen e kuotave tarifore, duke përfshirë raportet dhe analizat e inspektoratit përkatës dhe dokumenteve tjera përkatëse.

Neni 5

Kuotat tarifore

1. Aplikimi i një kuote tarifore lejon importin e një sasive të caktuar të një malli, gjatë periudhave të përcaktuara kohore, pa tatim doganor ose me një normë më të ulët doganore, ndërsa sasi të që tejkalojnë kuotën i nënshtrohen një norme më të lartë doganore, duke i përjashtuar detyrimet antidumping të përcaktuara sipas legjislacionit përkatës.

2. Sasia që importohet mund të shprehet në njësi të sasisë, vlerës, vëllimit ose peshës.

3. Afati kohor për vlefshmërinë e kuotës tarifore do të përcaktohet me vendim të Qeverisë siç përcaktohet edhe në Nenin 9 paragrafi 3 i Ligjit.

4. Kuotat e importit kontrollojnë sasinë, vlerën, vëllimin ose peshën e mallrave të ndryshme që mund të importohen në vend gjatë një periudhe të caktuar kohore.

5. Në rast se pas shpalljes së njoftimit për aplikimin e kuotave të caktuara në importe e deri në ditën e hyrjes në fuqi të kuotave në fjalë, vërehet një rritje e pazakonshme e importit të produktit/ve të paraparë në kuotë, Qeveria ka të drejtë që të aplikoj masë të menjëhershme mbrojtëse në import siç përcaktohet edhe në Nenin 9 paragrafi 3 i Ligjit.

6. Ministria përgjegjëse për tregti dhe Dogana e Kosovës përmes Tarifës së integruar të Kosovës – TARIK, publikojnë informacionet e detajuara mbi sasi të kuotave, periudhën kohore të kuotave dhe alokimet e kuotave për mallrat e listuara.

Neni 6 **Kuotat e importit**

1. Kuotat e importit janë dy lloje: absolute dhe tarifore.

1.1. Kuotat e importit absolute aplikohen në rastet kur kufizohet që rreptësisht të ndalohej hyrja e sasisë së mallrave në tregun vendor për një periudhë të caktuar. Pasi të plotësohet sasia e lejuar në një kuotë të importit absolut, nuk lejohet hyrja e mallit në tregun vendor ose tërheqja e tij nga depot doganore për konsum të mallrave që i nënshtrohen kuotës.

1.2. Kuotat e importit të normave tarifore aplikohen në rastet kur lejohet që një sasi e caktuar mallrash të importuara hynë në tregun vendor me një normë të reduktuar doganore gjatë periudhës së kuotës. Pasi të arrihet kufiri i kuotës së tarifës, mallrat mund të hynë ende, por me një normë më të lartë të tarifës doganore.

Neni 7 **Administrimi i kuotave**

1. Kuotat administrohen në përputhje me metodat si më poshtë:

1.1. Parimi “kush vjen i pari, shërbehet i pari” dhe

1.2. Lejet e importit.

Neni 8 **Parimi “kush vjen i pari, shërbehet i pari”**

1.1 Ndalohet diskriminimi ndërmjet operatorëve ekonomik të cilët aplikojnë për kuotat tarifore, duke aplikuar metodën e bazuar në rendin kronologjik të paraqitjes së aplikacioneve “kush vjen i pari, shërbehet i pari”.

1.2 Kuotat tarifore administrohen në mënyrë që të shmang çdo diskriminim ndërmjet operatorëve në fjalë.

Neni 9 **Mënyra e shpërndarjes së kuotave tarifore**

1. Mënyra e shpërndarjes së kuotës tarifore varet nga kodi tarifor dhe sasia e kuotave të përcaktuara.

2. Subjekti ekonomik që aplikon për një kuotë të caktuar, duhet të dëshmojë kapacitetin e tij për tregtimin e sasisë/vlerës së mallit për të cilin po aplikon, duke dëshmuar sasinë e importuar për vitin paraprak.

3. Subjekti ekonomik nuk mundet të aplikoj për një kuotë tarifore në vlerë/sasi më të madhe se 100% e vlerës së mallit të importuar nga subjekti i njëjtë ekonomik brenda vitit kalendarik, pa kufizim përmes kuotave.

4. Një subjekt i njëjtë ekonomik nuk mundet të aplikoj për më shumë se 10% të vlerës së kuotës së përgjithshme. Përrjashtimisht bëjnë rastet kur numri i aplikuesve është me i vogël se 10 aplikues.

Neni 10 **Thirrja publike**

1. Ministria përkatëse pasi që Qeveria nxjerr vendim konform nenit 4 paragrafi 2 të këtij udhëzimi, përmes thirrjes publike do të publikojë njoftimin për sasinë, vlerën, vëllimin ose peshën e përgjithshme të produktit dhe pjesët e alokuara në të, të cilat do të lejohen të importohen gjatë një periudhe të caktuar si dhe për çdo ndryshim në sasinë, vlerën, vëllimin ose peshën e përgjithshme për shpërndarjen e kuotave tarifore.

2. Thirrja publike për shpërndarjen e kuotave tarifore përmban këto informacione:

2.1. sasinë, vlerën, vëllimin ose peshën totale të kuotës tarifore;

2.2. kodet tarifore për përcaktimin e llojit dhe emërtimin e produktit;

2.3. dokumentacionin bashkëlidhur kërkesës;

2.4. afatin për paraqitjen e kërkesës përfshirë kohën e aplikimit;

2.5. afatin kohor për vlefshmërinë e lejes për kuotën tarifore;

2.6. Ministria mund të kërkojë edhe informacione tjera shtesë nëse e sheh të nevojshme.

3. Thirrja publike publikohet në afat prej 15 ditësh.

Neni 11 **Periudha e vlefshmërisë së kuotave tarifore**

1. Kuotat tarifore do të përcaktohen në baza vjetore dhe sezonale.

2. Periudhat e kuotave tarifore mund të ndahen edhe në baza mujore.

Neni 12 **Paraqitja e kërkesave për leje importi**

1. Kërkesa për lejet e importit duhet të dorëzohet brenda afatit të përcaktuar sipas thirrjes publike.

2. Kërkesa duhet të dorëzohet në Departamentin e Tregtisë, në adresim për Komisionin për përcaktimin e shpërndarjes së kuotave tarifore.
3. Operatorët ekonomik kanë të drejtë të aplikojnë për secilën kuotë tarifore, sipas thirrjes publike.
4. Operatorët që aplikojnë për leje duhet të plotësojnë formularin me informacionet e përcaktuar në nenin 14 të këtij udhëzimi administrativ.

Neni 13

Të dhënat që duhet të prezantohen me rastin e aplikimit me kërkesë për leje për kuotë në import

1. Formulari i kërkesës për lejimin e një kuote duhet të përfshijë informatat si në vijim:
 - 1.1. emri i kompanisë;
 - 1.2. emri dhe mbiemri i/e aplikuesit ose përfaqësuesit të autorizuar të tij;
 - 1.3. veprimtaria kryesore e biznesit;
 - 1.4. sasia, vlera, vëllimi ose pesha për të cilën aplikon subjekti;
 - 1.5. emërtimi i produktit për të cilin subjekti aplikon për kuotë;
 - 1.6. numri tarifor 8 shifror i produktit për të cilin subjekti aplikon për kuotë;
 - 1.7. sasia dhe vlera e produktit të importuar nga subjekti që aplikon, gjatë periudhës 1 vjeçare para se të aplikoj për kuotë, dhe
 - 1.8. origjina e produktit.

Neni 14

Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e lejes për kuotat tarifore në importe

1. Dokumentacioni i nevojshëm për marrjen e lejes për kuotat tarifore në importe është si:
 - 1.1. formulari i plotësuar;
 - 1.2. certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat përcjellëse;
 - 1.3. pasqyrat e importit për periudhën një vjeçare të vitit të fundit.

Neni 15

Komisioni për përcaktimin e shpërndarjes së kuotave tarifore

1. Komisioni formohet me vendim të Ministrit/es dhe përbëhet nga 5 anëtarë. Dy prej anëtarëve do të jenë nga Ministria përgjegjëse për tregti, një nga Dogana e Kosovës, si dhe dy anëtarë ad-hoc nga Ministria e fushës përkatëse.

2. Tre anëtarët e rregullt të Komisionit do të kenë mandat tre vjeçar, mund të rizgjidhen vetëm edhe për një mandat.

3. Kompetencat e Komisionit janë:

3.1 vlerëson plotësimin e kushteve formale për shqyrtimin e kërkesës për marrjen e lejes në afat prej 30 ditësh dhe konstaton se cilat kërkesa janë parashtruar në përputhje me thirrjen publike;

3.2 shqyrton kërkesat dhe i rekomandon Ministrit/es dhënien, pezullimin, revokimin, tërheqjen dhe refuzimin e lejes për kuotat në importe;

3.3 përgatit propozimin për shpërndarjen e kuotave tarifore dhe raportin ia dorëzon Ministres/it.

Neni 16

Shqyrtimi i kërkesës për leje

1. Aplikacionet për leje që nuk përmbajnë dokumentacionin e përcaktuar në këtë udhëzim administrativ konsiderohen të papranueshme.

2. Kërkesa nuk do të shqyrtohet në rastet në vijim:

2.1. nëse kërkesa nuk është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar në thirrjen publike;

2.2. nëse kërkesa nuk shoqërohet me dokumentacionin e përcaktuar në nenin 14 të këtij udhëzimi, dhe

2.3. nëse formulari i kërkesës nuk është plotësuar saktë;

Neni 17

Miratimi i kërkesave

1. Ministri/ja nxjerr vendim në bazë të rekomandimit të Komisionit vlerësues për miratimin, refuzimin, pezullimin apo revokimin për shpërndarjen e kuotave tarifore.

2. Vendimi nga ky nen është akt administrativ përfundimtar në kuptim të ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative. Ndaj vendimit lejohet padi në gjykatë sipas ligjit përkatës për konfliktet administrative.

Neni 18

Lejet e importit

1. Lejet e importit jepen jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike për lejet automatike dhe jo më vonë se tridhjetë (30) ditë kalendarike për lejet jo-automatike nga të dhëna mbi bazën e shërbimeve të parë.

2. Leja e importit nuk mund të bartet te një person tjetër fizik apo juridik.

Neni 19

Pezullimi dhe revokimi

1. Në rastet kur vërtetohet se operatorët ekonomik të cilët janë pajisur me leje të importit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe vendimin për emërim, Komisioni për emërim i rekomandon Ministrit/es marrjen e vendimit për pezullim apo revokimin e lejes për kuotën tarifore.

2. Revokimi i lejes për kuotën tarifore mund të iniciohet mbi bazën e inspektimit nga inspektorati i tregut ose nga Dogana e Kosovës.

3. Kohëzgjatja e pezullimit nuk duhet të kalojë periudhën e kuotës tarifore.

4. Vendimi nga ky nen është akt administrativ përfundimtar në kuptim të ligjit përkatës për procedurën e përgjithshme administrative. Ndaj vendimit lejohet padi në gjykatë sipas ligjit përkatës për konfliktet administrative.

Neni 20

Tërheqja e lejes

Ministri/ja tërheq lejen për import me kërkesë të operatorit të regjistruar, pas rekomandimit të Komisionit.

Neni 21

Publikimi i emrave të operatorëve që marrin leje për kuota tarifore

1. Njoftimi lidhur me vendimin për kuotat në importe, publikohet në web faqen e Ministrisë përkatëse për tregti dhe në atë të Doganës së Kosovës.

2. Ministria dhe Dogana e Kosovës do të publikojnë në faqet e tyre zyrtare emrat e Operatorëve Ekonomik dhe Numrin unik, si dhe adresat e identifikimit të operatorëve të cilët kanë marrë leje për kuotat tarifore.

3. Të dhënat e përmendura në paragrafin 2 hiqen nga faqja zyrtare varësisht nga përfundimi i periudhës kohore të përcaktuar për kuotat tarifore, ose sipas kërkesës së operatorit të regjistruar.

Neni 22

Njoftimi për përmbushjen e kuotës

Dogana e Kosovës e njofton Ministrinë për përmbushjen e kuotave për secilin importues.

Neni 23
Kufizimet në eksport

Ky Udhëzim Administrativ zbatohet përshtatshëmrisht edhe për kufizimet në eksport.

Neni 24
Shtojcat

1. Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi Administrativ janë shtojcat si në vijim:

1.1.Shtojca 1 (formulari i aplikimit);

1.2.Shtojca 2 (Shpallja/Njoftimi për Kuote Tarifore për një produkt te caktuar);

1.3.Shtojca 3 (Leje Importi).

Neni 25
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim administrativ hynë në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

06.08.2024

Rozeta Hajdari

Ministre

Shtojca nr. 1. Formulari i aplikimit për leje importi/Appendix no. 1. Import permit application form/Dodatak br. 1. Obrazac zahteva za uvoznu dozvolu

Emri i subjektit ekonomik/ Name of the business/ Naziv privrednog subjekta Adresa/ Address/ Adresa NUI/UIN/JMB	
Emri dhe mbiemri i drejtorit ekzekutiv ose përfaqësuesit të autorizuar të tij/aplikuesit Name and surname of the executive director or his/her authorized representative/applicant Ime i prezime izvršnog direktora ili njegovog ovlašćenog predstavnika/podnosioca zahteva	
Veprimtaria kryesore e kompanisë The main activity of the company Osnovna delatnost preduzeća	
Sasia e kuotës për të cilën aplikon subjekti The amount of the quota for which the subject applies Iznos kvote za koji subjekt aplicira	
Emërtimi i produktit për të cilin subjekti aplikon për kuote Name of the product for which the subject applies for quotes Naziv proizvoda za koji se predmet prijavljuje za ponude	
Numri tarifor (8 shifror) i produktit për të cilin subjekti aplikon për kuotë Tariff number (8 digits) of the product for which the subject applies for quotes Tarifni broj (8 cifara) proizvoda za koji subjekt aplicira za kvote	
Sasia e importuar e produktit nga subjekti që aplikon, gjatë periudhës 1 vjeçare para se të aplikoj për kuotë The imported quantity of the product from the applying entity, during the 1 year before applying for the quota Uvezena količina proizvoda od subjekta koji podnosi zahtev, tokom 1-godišnjeg perioda pre podnošenja zahteva za kvotu	
Origjina e produktit/The origin of product/Poreklo robe	
Vendi dhe data e aplikimit/ Place and date of application/ Mesto i datum prijave	
Nënshkrimi dhe vula/ Signature and stamp/ Potpis i pečat	

Shtojca nr.2. Shpallja/Njoftimi për Kuotë Tarifore për një produkt te caktuar/Appendix no. 2. Announcement/Notice of Tariff Quotation for a specific product/ Prilog br.2. Najava/obaveštenje o tarifi za određeni proizvod

Numri rendor i shpalljes Ordinal number of the announcement Redni broj oglasa	<i>Të shënohet numri rendor i shpalljeve nga ana e Ministrisë To write down the ordinal number of announcements by the Ministry Da se napise redni broj oglasa Ministarstva</i>
Marrëveshje ndërkombëtare ose akt tjetër International agreement or other act Međunarodni ugovor ili drugi akt	<i>Duhet të përshkruhet se vendimi për aplikimin e kuotës a është marrë me marrëveshje ndërkombëtare apo është i bazuar ne ndonjë vendim specifik te Qeverise. It should be described whether the decision to apply the quota was made with an international agreement or is based on a specific decision of the Government. Triba opisati da li je odluka o primeni kvote doneta međunarodnim sporazumom ili je zasnovana na konkretnoj odluci Vlade.</i>
Periudha e kuotës tarifore Tariff Quota Period Period tarifne kvote	<i>Duhet të përshkruhet afati kohor në fuqi i kuotës së aplikuar/ The effective time frame of the applied quota must be described/ Mora biti opisan efektivni vremenski okvir primenjene kvote.</i>
Periudhe shtesë e kuotës tarifore Additional period of tariff quota Dodatni period tarifne kvote	<i>Duhet të tregohet se do të lejohet periudhë shtesë për kuotën apo jo? It must be shown that an additional period will be allowed for the quota or not? Mora se pokazati da će biti dozvoljen dodatni period za kvotu ili ne?</i>
Aplikim i licencës Application of licence Aplikacija licence	<i>Konform neneve 13, 14, 15, dhe 16 te këtij Udhëzimi Administrativ By articles 13, 14, 15, and 16 of this Administrative Instruction U skladu sa članovima 13, 14, 15 i 16 ovog Administrativnog uputstva</i>
Përshkrimi i produktit Description of the product Opis proizvoda	
Origjina e produktit Origin of product Poreklo proizvoda	<i>Po/Jo Yes/No Da/Ne</i>
Dëshmia e origjinës për lëshim ne qarkullim te lire Proof of origin for release into free circulation Dokaz o poreklu za puštanje u slobodan promet	<i>Po/Jo Yes/No Da/Ne</i>
Pesha ne kg Weight in kg Težina u kg	

Kodi tarifor i produktit Tariff code of product Tarifni broj robe	
Tatimi doganor brenda kuotës Customs tax within the quota Carinski porez u okviru kvote	<i>Duhet të tregohet se sa është norma doganore e aplikuar në produktin në fjalë për sasinë e përcaktuar me kuotë It must be shown how much is the customs rate applied to the product in question for the quantity determined by the quota Mora se pokazati kolika je carinska stopa koja se primenjuje na predmetni proizvod za količinu utvrđenu kvotom</i>
Dëshmia e tregtisë Trade evidence Dokaz o trgovini	<i>Po/Jo Yes/No Da/Ne</i>
Garancion sigurie për licencë të importit Security guarantee for import licenses Garancija sigurnosti za uvozne dozvole	<i>Po/Jo Yes/No Da/Ne</i>
Periudha e validitetit të lejes Permit's validity period Period važenja dozvole	
Transferi/bartja e lejes Permit's Transfer Prenos/prenošenje dozvole	<i>Po/Jo Yes/No Da/Ne</i>
Operatori i regjistruar në ARBK Operator registered in ABRK Operater registrovan u ARBK	<i>Po/Jo Yes/No Da/Ne</i>
Kushtet specifike Specific conditions Specifični uslovi	

Shtojca Nr. 3. Leje Importi / Appendix no. 3. Import Permit / Prilog br.3. Dozvola za uvoz

Autoriteti që lëshon lejen (emri dhe adresa e autoritetit)	
--	--

The authority that issues the license (name and address of authority) Organ koji izdaje dozvolu (naziv i adresa organa)	
Lëshuar për/ Issued to/ Izdata: Emri i kompanisë/ The name of the company / Ime kompanije: Adresa e plote/ Full address/Puna adresa: Numri unik identifikues/Unique identification number/ Jedinstveni matični broj:	
Vendi eksportues/ Exporting country/ zemlja izvoznica	
Vendi i origjinës /Country of origin/ zemlja porekla	
Data e paraqitjes se kërkesës për licence/ The date of submission of the license application/ Datum podnošenja zahteva za licencu	
Dita e fundit e afatit të lejes/ The last day of the permit term / Poslednji dan trajanja dozvole	
Produkti që do të importohet/emërtimi tregtar i produktit The product to be imported/trade name of the product Proizvod koji se uvozi/trgovačko ime proizvoda	
Përshkrimi i produktit në përputhje me nomenklaturën e kombinuar Product description in line with the combined nomenclature Opis proizvoda u skladu sa kombinovanom nomenklaturom	
Kodi tarifor / Tariff code / Tarifski kod	
Sasia në shifra Quantity in numbers Kolicina u brojevima	
Sasia në të shkruar me shkronja The amount written in letters Iznos napisan slovima	
Kushte të veçanta/ Special conditions / Posebni uslovi	
Lëshuar në: (vendi) / Issued in: (place) / Izdato u: (mesto)	
Date:/ Date:/Datum:	
Nënshkrimi dhe vula e autoritetit që lëshon leje: Signature and stamp of the permit's issuing authority: Potpis i pečat organa koji je izdao dozvolu:	